



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMEVE

Nr. 2907/4 Prot

Shkodër, më 11.04.2023

KONTRATË SIPËRMARRJE  
PUNË PUBLIKE  
REF-59920-02-22-2023  
"Rikonstruksion rruga Kraje"

E lidhur sot me datë 11.04 2023, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z. Bardh Spahia** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet Autoriteti Kontraktor.

Dhe Operatorit ekonomik "Nika" sh.p.k regjistruar me regjistrim fillestar nr. CN-040374-09-07 me license profesionale te shoqerise nr. NZ.2798/16 date 20.11.2017 me vlefshmeri te licenses pa afat kohor leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise me seli te shoqerise: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeg, godine 8-kateshe,kati i I-re-Shkoder me NUIS J 76705047 U , e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise Zj.Shpresa Nika me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqerine, në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet "Kontraktuesi"

**Neni 1**

**Baza ligjore**

1. Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
2. Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik",
3. VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",e ndryshuar
4. Ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar,
5. Udhëzimi i K.M nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
6. Ligji nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar.



NIKA SH.P.K  
NIPT: 76705047U  
SHKODER

## Neni 2

### Objekti i kontratës

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: **Rikonstruksion rruga Kraje** " në përputhje të plote me projektin dhe specifikimet teknike dhe që **Kontraktuesi**– “ **Nika**” **sh.p.k.** pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

## Neni 3

### Vlefte e kontratës

- 3.1 Autoriteti Kontraktor i beson Kontraktorit realizimin e punimeve civile për objektin e lartpërmendur dhe Kontraktori merr përsiper realizimin e tyre kundrejt një vlere totale prej **3,328,630** leke pa TVSH (Tremilion e treqind e njezet e tetemije e gjashtëqind e tridhjetë) dhe **3,994,356** leke me tvsh (Tremilion e nentëqind e nentëdhjetë e kater mije e treqind e pesëdhjetë e gjashtë).
- 3.2 Burimi i financimit: Buxheti i Bashkise viti 2023 i miratuar me VKB Nr. 71 date 27.12.2022 “Per miratimin e Buxhetit te vitit 2023 dhe programit buxhetor Afatmesem perfundimtar 2023 - 2025 te Bashkise se Shkodres”.
- 3.3 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 28.

## Neni 4

### Afati i kontratës

- 4.1 Afati i realizimit të punimeve është periudha prej **4 (Kater) muajsh** duke filluar nga dita që kontraktorit i jepet leja për të hyrë në kantier, kohë në të cilën do të fillojnë efektet teknike dhe financiare të zbatimit të kësaj kontrate. Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier menjëherë pasi të jetë bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Ky shesh do të dorëzohet në prani të Drejtuesit të Projektit dhe Kontraktorit dhe prej tyre do të mbahet një procesverbal për të zyrtarizuar këtë fakt.

## Neni 5

### Gjuha e kontratës

- 5.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
- 5.2 Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.
- 5.3 Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.
- 5.4 Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.
- 5.5 Kontraktuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Kontraktuesi.

## Neni 6

## Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e punëve të prokuruar në bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 6.2 Ligji për prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk merr në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të ligjit mbi prokurimin publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk merr në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të ligjit mbi prokurimin publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e paleve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lenë menjëherë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu kushtet e veçanta të kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.

## Neni 7

### Përkufizime

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

#### Kontrata

- 7.1 "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve në përputhje me LPP.
- 7.2 "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 7.3 "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesi siç specifikohet në kontratë.
- 7.4 "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Kontraktuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 7.5 "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në **Nenin 32**.
- 7.6 "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e punimeve, materialeve/pajisjeve/ produkteve që do të përdoren për realizimin e objektit të kontratës dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 7.7 "Projekte teknike" paraqitja e detajuar në mënyrë vizuale dhe skematike (në vizatimet përkatëse) të kërkesave të autoritetit kontraktor sa i takon përmasave, volumeve apo detajeve teknike të objektit të prokurimit, sipas formateve dhe/ose standardeve të parashikuara në legjislacionin e fushës. Përkatëse.

7.8 "Preventiv total" do të thotë volumet e punës të dhëna në projekt të cilat janë orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

7.9 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

"Projekt – ide" do të thotë kërkesat e autoritetit kontraktor mbi objektin e kontratës, të paraqitura në mënyrë skematike apo grafike, jo detyrimisht plotësisht të detajuara, por që përfshijnë të paktën të dhënat minimale të pandryshueshme, të asaj çfarë kërkohet të realizohet.

"Terma reference"do të thotë pasqyrimi i qëllimit, apo strukturave të një projekti ku cilësohen vizioni, objektivat, fushëveprimi, për produktin e pritshëm, si dhe stafi, rolet dhe përgjegjësitë e tij, për realizimin e produktit që kërkohet.

"Pajisje" do të thotë makineritë, mjetet dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

"Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

"Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

"Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

"Afati i realizimit te punimeve" do të thotë koha e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës, e shprehur në mënyrë të detajuar në Grafikon e Realizimit të Punimeve.

"Katalog" do të thotë një "libër" që përmban listën e materialeve/pajisjeve/produkteve përfshirë përshkrimet e cilësive/specifikimeve, si dhe mënyrën e montimit/instalimit apo të përdorimit të tyre."Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

"Kantier" do të thotë vendi fizik (vendndodhja) ku do të realizohen punimet objekt kontrate.

"Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.


"Regjistrat e veprimtarive dhe/ose çështjeve" dokument ku regjistrohen të gjitha veprimtaritë, proceset apo çështjet që kanë ndodhur gjatë ekzekutimit të punëve, me datën, shkaku, masat përmirësuese të ndërmarra nëse është rasti, palën përgjegjëse, statusin apo gjendjen e tyre në përfundim të masave të ndërmarra.

7.10 "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Kontraktori ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

7.11 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

7.12 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## 8 Palët e kontratës



8.1 "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Autoritetit kontraktor dhe Kontraktorit (realizuesit të punimeve) sipas kontekstit.

8.2 "Kontraktori" do të thotë operatori (ët) ekonomik që do të realizojë punimet objekt kontrate.

8.3 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për ofrimin e një pjese të punëve ose Shërbimeve të Lidhura me to.

## 9 Datat, Testet, Periudhat dhe Përfundimi

9.1 "Test i materiale/pajisjeve" do të thotë testet (nëse janë të aplikueshme) të cilat janë specifikuar në Kontratë dhe që kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe legjislacionin e fushës, për qëllimin e përcaktimit të parametrave të materialeve/pajisjeve, para se të lejohet përdorimi/montimi/instalimi i tyre në objekt.

9.2 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

## 10 Punimet

10.1 "Punime" do të thotë të gjitha proceset që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori për realizimin e objektit të kontratës. Përfshijnë germimin, ndërtimin, riparimin, rinovimin, instalimin, formatimit, testimin, zhvendosjen, transportin dhe çdo proces që është parashikuara në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit

10.2 "Shërbime të Lidhura" do të thotë shërbimet e rastit të lidhura me realizimin e proceseve, siç janë sigurimi, transporti, instalimi, vënia në punë, trajnimi dhe mirëmbajtja fillestare ose ndonjë shërbim tjetër i kësaj natyre sipas Kontratës.

## 11 Përkufizime të tjera

11.1 "Adresa e autoritetit kontraktor" është adresa e specifikuar në KVK.

11.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 29 "Forca Madhore".

11.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 14 "Sigurimi i Kontratës".

11.4 "Vendi i realizimit të kontratës" apo "kantieri", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

11.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

11.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 26.

11.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK


11.8 "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

## 12 Interpretimi

12.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;



(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

## **12.2 Inkotermat**

(a) "Inkotermat" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

(b) Përveçse kur nuk është në përputhje me ndonjë dispozitë të Kontratës, kuptimi i çdo termi tregtar dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve në të do të jenë siç përshkruhet nga Inkotermat.

(c) Inkotermat, kur përdoren, rregullohen nga rregullat e përshkruara në botimin aktual të Inkotermave, të specifikuara në KVK, dhe të publikuara nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

## **12.3 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

## **12.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

## **13 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënie ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK; dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

## **14 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

## **15 Hartimi i Kontratës**



NIKOLLA P. K.  
NIPT: 07050470  
SHKODER

**15.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**15.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

## **16 E drejta e autorit**

**16.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha vizatimet, dokumentet, produktet, pajisjet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna autoritetit kontraktor nga kontraktori këtu do t'i mbeten këtij të fundit, edhe nëse ato i janë vënë në dispozicion autoritetit kontraktor drejtpërdrejt nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve/produkteve apo pajisjeve që përdoren për realizimin e punimeve objekt kontrate.

## **17 Detaje Konfidenciale**

Kontraktori dhe personeli i autoritetit kontraktor do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Kontraktuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të proceseve, materialeve/produkteve apo pajisjeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, kontraktorët lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tyre për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Kontraktori mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga autoriteti kontraktor në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Kontraktorit sipas këtij neni.

## **18 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Kontraktori respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Kontraktori siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Autoritetit Kontraktor që:

(i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Kontraktorit të sigurojë në emër të tij dhe  
(ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Kontraktori ashtu dhe Autoriteti Kontraktor sipas Kontratës;

(b) Kontraktori siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Autoritetit Kontraktor që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë

Kontraktorit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Kontraktorit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha materialet/pajisjet/produket apo makineritë e importuara të Kontraktorit. Kontraktori siguron të gjitha lejet, miratimet dhe licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Autoritetit Kontraktor sipas pikës 1.9 (a) këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Kontraktori do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Autoritetin Kontraktor nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Kontraktori ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cenuar **Nenin 3**.

### **19 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Kontraktori është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

### **20 Inspektimet dhe Auditimi nga Autoriteti Kontraktor**

Kontraktori i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Autoritetit Kontraktor çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndalura, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Autoritetit Kontraktor të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Autoritetit Kontraktor të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Kontraktori mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 8**

### **Praktikat e ndaluara**

- 8.1** Kontraktori nuk/do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndalura në lidhje me prokurimin, dhënieve ose ekzekutimin e Kontratës.
- 8.2** Nëse Autoriteti kontraktor konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.  
Nëse Autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

## **Neni 9**

### **Njoftimet**

- 9.1** Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 9.2** Njoftimi do të ketë efekt sipas të dorëzohet.

## **Neni 10**



## Realizimi i punimeve

- 10.1 Realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti, si dhe i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me standardet teknike në fuqi.

### Neni 11

#### Përgjegjësitë e Kontraktorit

- 11.1 Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimi i të gjitha punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, nëse është rasti si dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në objektin e kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me standardet teknike në fuqi.
- 11.2 Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së ambientit duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.
- 11.3 Kontraktori është i detyruar të rrethojë kantierin e punimeve të ndërtimit në datën e fillimit dhe hyrjes në kantier sipas standardeve të përcaktuara.
- 11.4 Kontraktori është i detyruar të lagë me ujë zonën e kantierit të punimeve të ndërtimit me qëllim eliminimin e ndotjes së mjedisit si rrjedhim i kryerjes së punimeve.
- 11.5 Kontraktori është i detyruar të pajisë me uniformë pune të gjithë personelin punëtor. Uniformat e punës duhet të kenë të evidentuar emrin e kontraktorit si dhe të jenë të pajisura me shirita fosforike për tu dalluar natën.
- 11.6 Kontraktori është i detyruar të përdori mjetet e sinjalistikes rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtareve në objektin e ndërtimit. Këto mjete duhet të vendosen në mënyre të dukshme për të gjithë.
- 11.7 Kontraktori është i detyruar të vendosë në kantier të gjitha makineritë dhe mjetet e paraqitura në ofertë, mbi bazën e së ciles ai është shpallur fitues. Mjetet e qarkullimit duhet të jenë të pajisura me lejet përkatëse.
- 11.8 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor sic kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.
- 11.9 Kontraktori pas përfundimit të kontratës duhet ti dorëzojë Autoritetit kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramat, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe rregjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose të përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet ti përdori për qëllime që nuk kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 11.10 Kontraktori do të kryejë punimet dhe do të jetë përgjegjës vete për saktësinë e kryerjes së punimeve.
- 11.11 Kontraktori është i detyruar të zevëndesoje përfaqesuesit e vet dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur kjo gjë kërkohet nga Drejtuesi i Projektit / Autoriteti Kontraktor. Drejtuesi i Projektit i drejtohet me shkrim Kontraktorit, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paafësitë arbitrare në zgjidhjen e problemeve



teknike ose pakujdesi të rënda. Kontraktori duhet të marre masa për të siguruar që punonjësi në fjale të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 oreve dhe të mos ketë më lidhje me zbatimin e kësaj kontrate.

## Neni 12

### Kushtet e Pagesës

- 12.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
- 12.2 Kontraktori duhet të paguhet nga Autoriteti Kontraktor punimet e realizuara, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.
- 12.3 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Autoriteti Kontraktor, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Kontraktori, dhe pasi Autoriteti Kontraktor ta ketë pranuar atë. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës
- 12.4 Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse Kontraktori ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

## Neni 13

### Tatimet, Taksat dhe Detyrimet e tjera

- 13.1 Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor, Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, taksat e pullës, tarifat e licencës dhe detyrime të tjera të tilla të vendosura jashtë vendit të Autoritetit Kontraktor
- 13.2 Për materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të prodhuara brenda vendit të Autoritetit Kontraktor Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha tatimet dhe taksat, detyrimet, tarifat e licencës, etj., të lindura deri në realizimin e plotë dhe dorëzimin e objektit të kontratës, të Autoritetit Kontraktor
- 13.3 Nëse në vendin e Autoritetit Kontraktor mund të jetë i disponueshëm për Kontraktorin ndonjë përjashtim, ulje, lejim ose favor tatimor, Autoriteti Kontraktor duhet t'i krijojë mundësinë Kontraktorin të përfitojë nga këto lehtësira. Kontraktori është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 dite para datës së hapjes së tenderit të cilat Kontraktori duhet ti ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk do ti njohin asnjë shtesë pagese.

- 13.4 Nëse Kontraktori nuk është i regjistruar si subjekt që ushtron aktivitet në qytetin e Shkodrës është i detyruar ta regjistrojë këto aktivitete pranë QKB, tek seksioni “*vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia*” duke vendosur adresën e saktë të kantierit ku kryen punimet, dhe të shlyejë ato taksa dhe tarifa vendore që kanë të bëjnë me realizimin e aktivitetit të perkohshëm në qytetin e Shkodrës.

#### Neni 14

##### Sigurimi i Kontratës

- 14.1 Kontraktuesi, brenda afatit të caktuar nga Autoriteti Kontraktor në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 14.2 Në përputhje me Nenin 14.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor i në KVK.
- 14.3 Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Kontraktorit.
- 14.4 Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Kontraktorit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Kontraktorit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

#### Neni 15

##### Nënkontraktimi

- 15.1 Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 15.2 Autoriteti Kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për punët që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Kontraktuesit. Parashikimet e Nenit 8 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

#### Neni 16

##### Specifikimet dhe Standardet

- 16.1 Kontraktori duhet të sigurojë që punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjet/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës, të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me standardet teknike në fuqi.
- Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekte, preventiv, detyrë projektimi, terma reference, ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktori duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoriteti Kontraktor për të.
- Kudo që bëhen referenca në Kontratë për kodet dhe standardet, në përputhje me të cilat do të ekzekutohet, shtesa ose versioni i rishikuar i kodeve dhe

standardeve të tilla, do të jenë ato të specifikuara në kërkesat e dokumenteve të tenderit. Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard, gjatë ekzekutimit të Kontratës, do të zbatohet vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor i dhe do të trajtohet në përputhje me Nenin 30 të këtyre kushteve dhe dispozitat e LPP-së për modifikimin e Kontratës, Neni 127

- 16.2** Kontraktori, në rast se evitohen mospërputhje apo mangësi në projekt-preventiv dhe kantier, brenda një afati të përcaktuar në kontratë, paraqet kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës.
- 16.3** Autoriteti Kontraktor administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të shqyrtohen në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

## Neni 17

### Testimet dhe Inspektimet

- 17.1** Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës. Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.
- 17.2** Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.
- 17.3** Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 17.4** As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

## Neni 18

### Siguracioni

- 18.1** Përveç nëse specifikohet ndryshe në KVK, Kontraktuesi duhet të sigurojë punimet, Shërbimet e Lidhura, apo materialet/pajisjte/produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës janë plotësisht të siguruar ndaj humbjes ose dëmtimit të lidhur me realizimin, prodhimin ose blerjen, transportin, apo cdo procesi tjetër, në përputhje me Inkotermat e zbatueshme ose në mënyrën e specifikuar në KVK.



SH. P. X  
NIPU 767050470  
SHKODER

## Neni 19

### Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 19.1** Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 19.2** Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

## Neni 20

### Zbulimet

- 20.1** Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

## Neni 21

### Disponimi i Kantierit

- 21.1** Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

## Neni 22

### Masat në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë

- 22.1** Autoriteti Kontraktor duhet dhe Kontraktori duhet të sigurohen, që gjatë zbatimit të kontratës të përmbushin detyrimet lidhur me kërkesat e sigurisë së shëndetit, punëve, ambientit për punët, apo nevojave për aftësi ose përvojë të specializuar mjedisore, sociale ose shëndetësore dhe të sigurisë, sikurse përcaktohet gjatë përgatitjes së dokumenteve të prokurimit.
- 22.2** Specialistët e sigurisë në punë, pjesë e stafit/personelit të Kontraktorit, duhet të disponojnë kualifikimet e parashikuara në legjislacionin e fushës, për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e sigurisë në punë, gjatë zbatimit të objektit të kontratës.

## Neni 23

### Raportimi i Grafikut të Zbatimit



- 23.1** Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
- 23.2** Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteve.

#### **Neni 24**

##### **Dëmet e likuiduara**

- 24.1** Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

#### **Neni 25**

##### **Garancia**

- 25.1** Kontraktori garanton se materialet/pajisjet/produktet e përdorura gjatë realizimit të punimeve janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se sigurojnë përmirësimet e duhura të objektit të prokurimit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë. Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se punimet apo materialet/pajisjet/produktet e përdorura gjatë realizimit të punimeve, nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi/zbatimi, cilësia e tyre në prodhim, apo nga puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.
- 25.2** Autoriteti Kontraktor përcakton në KVK kohëzgjatjen e vlefshmërisë së garancisë (nëse është rasti), pasi punimet objekt kontrate, ose ndonjë pjesë e tyre sipas rasti, të jenë realizuar dhe marrë në dorëzim pas përfundimit të tyre
- 25.3** Kontraktori do të njoftojë Autoritetin Kontraktor duke treguar natyrën e problemeve/defekteve të tilla së bashku me të gjitha provat e disponueshme të tyre, menjëherë pas zbulimit të tyre, por jo më vonë se dhjetë ditë nga zbulimi. Autoriteti



RIKAZIMI P.K  
NIPT. 7050470  
SHKODER

Kontraktor do të sigurojë të gjitha mundësitë që Kontraktori të inspektojë defekte të tilla.

- 25.4** Pas marrjes së njoftimit, Kontraktori i duhet, brenda periudhës së specifikuar në KVK, të riparojë ose zëvendësojë me shpejtësi materialet/pajisjet/produktet ose pjesët e dëmtuara, pa ndonjë kosto për Autoritetin Kontraktor. Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktori nuk arrin të rregullojë defektin brenda periudhës së specifikuar më sipër, Autoriteti Kontraktor mund të kryejë rregullimet e nevojshme me shpenzimet e Kontraktorit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor mund të vendosë që të njoftojë Kontraktuesin për ndërprerjen e Kontratës

## Neni 26

### Zhdëmtimi i Patentës

- 26.1** Kontraktori dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Autoriteti Kontraktor mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:
- (a) realizimit të punimeve apo instalimit të materialeve/pajisjeve/produkteve gjatë realizimit të objektit të kontratës
- Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse materialet/pajisjet/produktet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është paraqitur nga Kontraktori, në përputhje me Kontratën.
- 26.2.** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Autoritetit Kontraktor që del nga çështjet e përmendura në Nenin 22.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Kontraktorin dhe Kontraktori mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Autoritetit Kontraktor të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.
- 26.3** Nëse Kontraktori nuk e njofton Autoritetin Kontraktor brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Autoritetin Kontraktor do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.
- Autoriteti Kontraktor me kërkesën e Kontraktorit, do ti japë këtij të fundit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Kontraktori për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.
- Autoriteti Kontraktor dëmshpërblen dhe zhdëmton Kontraktorin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Kontraktori mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo projekt, specifikim teknik, të



dhënë, vizatim, apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Autoritetit Kontraktor.

## Neni 27

### Kufizimi i Përgjegjësisë

**27.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Kontraktori për t'i paguar Autoritetit Kontraktor dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Kontraktori ndaj Autoritetit Kontraktor, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e riparimit ose zëvendësimit të materialet/pajisjet/produktet me defekt, ose çdo detyrim të Kontraktori për të zhdëmtuar Autoritetit Kontraktor në lidhje me shkeljen e patentës.

## Neni 28


### Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

**28.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 29

### Forca Madhore

- 29.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
- 29.2** Për qëllime të këtij neni "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmybtjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.
- 29.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të



Handwritten signature in blue ink.



kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

### Neni 30

#### Modifikimi i Kontratës

- 30.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 30.2** Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
  - b) Korrigjime në materiale
  - c) Korrigjime në sasi
- 30.3** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 30.4** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

### Neni 31

#### Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit

- 31.1** Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 31.2** Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 31.3** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Kontraktori ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë realizimin në kohë të punimeve objekt kontrate në përputhje me Nenin 10, Kontraktori njofton menjëherë Autoritetit Kontraktor me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Kontraktorit, Autoritetit Kontraktor vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Kontraktorit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 31.4** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në **Nenin 29**, një vonesë nga Kontraktori në kryerjen e detyrimeve të përfundimit sipas grafikut të punimeve objekt kontrate do ta bëjë kontraktorin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likuiduara në përputhje me parashikimet në kontratë.
- 31.5** Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin

Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

## Neni 32

### Ndërprerja e Kontratës

#### 32.1 Njoftim për të korrigjuar

Nëse Kontraktori nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund ti kërkojë me Njoftim që të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

#### 32.2 Ndërprerja për mospërmbushje

Autoriteti Kontraktor pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Kontraktorit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

- kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë: ose,
- kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- Nëse provohet se Kontraktori është angazhuar në Praktika të Ndaluar, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

#### 32.3 Ndërprerja për paaftësi paguese

Autoriteti Kontraktor ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Kontraktorin nëse Kontraktori falimenton. Kontraktori ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Autoriteti Kontraktor nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Kontraktorin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Autoritetin Kontraktor

#### 32.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- Autoriteti Kontraktor i mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për ndërprerjen.
- Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktorin për të gjitha punimet që janë marrë në dorëzim përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktorit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## Neni 33

### Objekti i Kontratës

33.1 Punimet, materialet pajisjet/produktet dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të realizohen apo përdoren gjatë realizimit të kontratës duhet të jenë sipas



specifikimeve teknike, projekteve përkatëse, termave të referencës apo detyrës së projektimit nëse është rasti, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe me stardardet teknike në fuqi. Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Kontraktori, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

#### Neni 34

##### Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 34.1** Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.
- 34.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

#### Neni 35

##### Përfaqësimi i Palëve

- 35.1** Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
- a) Personi që do të jetë përgjegjës, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë **Ing. Geralda Goga** me detyrë specialist Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturaes, Sektori i Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturaes.  
cel/tel/fax 0692080818  
E-mail: [sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al](mailto:sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al)  
E-mail: [geri.gogaj@outlook.com](mailto:geri.gogaj@outlook.com)
- a) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë **Ing. Gentiana Mosko**.  
E-Mail: [nikashpk@yahoo.com](mailto:nikashpk@yahoo.com)  
Telefon: 0692097453
- 35.2** Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 35.3** Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet të dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 35.4** Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Ing. Geralda Goga** si personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës

dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

- 35.5** Struktura përgjegjëse duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
  - b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
  - c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
  - d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
  - dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
  - e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
  - ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
  - f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

### KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

#### Neni 1

#### Dispozitat e Përgjithshme

Blerësi është: **Bashkia Shkodër**

Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër

Telefoni: +35522400150

Numri i faksit: \_\_\_\_\_

E-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Furnizuesi është: **Nika sh.p.k**

Adresa: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeg, godine 8-kateshe, kati i I-re-  
Shkoder

Telefoni: 0692097453

Numri i faksit: \_\_\_\_\_

---

Adresa: Rr 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



E-Mail: [nikashpk@yahoo.com](mailto:nikashpk@yahoo.com)

Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**

Gjuha është: **Gjuha shqipe**

## Neni 2 Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10% të vlerës së ofertës me tvsh) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë:  
**Nuk ka**
- 2.3 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit të kontrates do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.  
**Periudha e garancisë për defektet është 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit të kontratës.**
- 2.4 Me përfundimin e kësaj periudhe kontraktori paraqet kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit cakton komisionin e marrjes në dorëzim të vepres, i cili, në bashkëpunim me Kontraktorin, Drejtuesin e Projektit, Kolaudatorin/Grupin e Kolaudimit, brenda 10 diteve, organizojnë viziten në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lena, korrigjimi i defekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë teknike të punimeve. Nëse janë kryer të gjithë korrigjimet e defekteve atëherë hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit (çertifikata) dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe atë të Drejtuesit të Projektit. Ky akt është subjekt i miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 2.5 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit e cila pasqyrohet në aktin e marrjes në dorëzim të objektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.
- 2.6 Garancia teknike do të paguhet nga Autoriteti Kontraktor mbas përfundimit të periudhës së garancisë teknike të punimeve dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor të aktit të marrjes në dorëzim të objektit (çertifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim) duke patur parasysh edhe ndalesat e aplikuara.

## Neni 3 Drejtuesi i Projektit

- 3.1 Bashkia Shkodër me të drejtën e Investitorit si Autoritet Kontraktor, në mbështetje të dispozitave ligjore për drejtuesin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe konkretisht Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 \*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën

e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve” nëpërmjet procedurës së prokurimit dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, përzgjedhi operatorin ekonomik “HE & SK 11” sh.p.k me administrator ligjor z. Festim Bregasi, Mbikqyrës të Punimeve në objektin : “Rikonstruktion rruga Krajej”, “HE & SK 11” sh.p.k i paisur me licencën përkatëse “Për mbikqyerje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit” nr.MK.2018/24 date 24.02.2023 me afat vlefshmerie deri me 25.02.2025 leshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjië, nr NUIS L19008502B, përfaqësuar nga administratori z. Festim Bregasi për mbikqyerjen e punimeve në objekt. Adresa/pika e kontaktit: Gjirokaster Tepelene TEPELENE Lagjja " Mustafa Matohiti", Rruga "Mustafa Matohiti", banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe, E-Mail: [heskshpk@gmail.com](mailto:heskshpk@gmail.com) Telefon: 0695309561


Detyrat e mbikqyrësve të punimeve burojnë nga akte ligjore dhe nenligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit. Mbikqyresi i Punimeve do të ushtroje të gjitha të drejtat dhe detyrimet që parashikohen në Ligjin nr-8402, dt 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit " i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

- 3.2 Në rast se Mbikqyresi i Punimeve do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.
- 3.3 Mbikëqyresi i punimeve do të vendosë për çështje të kontrates midis Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 3.4 Mbikëqyresi i punimeve mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjeret përveç zgjidhjes së mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Mbikëqyresi i Punimeve duhet të njoftojë me shkrim kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.
- 3.5 Mbikëqyresi i punimeve duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe të verifikojë shumën që duhet të paguhet kontraktorit, brenda 20 diteve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 3.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë , pagesa periodike për punët do të behet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga mbikqyrësi i punimeve.

#### Neni 4

##### Personeli i kontraktorit

- 4.1. Kontraktori është i detyruar të punësojë në kantier për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Drejtuesi i Projektit vetëm personelin inxhinierik të deklaruar në oferte.
- 4.2. Drejtuesi i Projektit do të propozojë Autoritetit Kontraktor për të zevëndësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të percaktuar në ofertën e Kontraktorit.
- 4.3. Nëqoftëse Drejtuesi i Projektit i kërkon Kontraktorit të largojë një person që është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit duke theksuar arsyet,



Kontraktori duhet të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos kete më lidhje me punën e përfshirë në kontratë

**4.1.** Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori Teknik është personi që Kontraktori ka percaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i punimeve do të jete **Ing. Gentiana Mosko**, i përfshirë në liçencën profesionale të shoqërisë nr. NZ.2798/16 date 20.11.2017 me vlefshmeri te licenses pa afat kohor leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

**4.2.** Detyrat e Drejtuesit Teknik janë si me poshtë:

- a. Eshtë përgjegjës për zbatimin e përpikte të projektit, sipas vizatimeve, përshkrimit teknik e ndryshimeve të miratuara, në përputhje me kerkesat e kushteve teknike të zbatimit, në fuqi, me specifikimet teknike të kontrates dhe sipas radhës teknologjike të punimeve.
- b. Të jetë i pranishëm dhe të përfaqësoje Kontraktorin në të gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit në zgjidhjen e diskutimin e çështjeve teknike e profesionale që lindin gjatë zbatimit të punimeve.
- c. Eshtë përgjegjës për dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt.
- d. Mban korrespondencën zyrtare me Mbikqyresin e Punimeve.
- e. Eshtë përgjegjës për ecurine e zbatimit të punimeve konform planorganizimit dhe grafikut të punimeve.
- f. Eshtë i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit, zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.
- g. Njofton Drejtuesin e Projektit, për pasaktësite, mospërputhjet, mungesat e të dhenave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike. Sa here që e gjykon të arsyeshme paraqet propozime tek Drejtuesi i Projektit dhe pret udhezimet.
- h. Instrukton dhe rinstrukton te gjithe punonjesit cdo fillim muaji, ne perputhje me programin mujor te punes.
- i. Sa here qe kerkohet nga Drejtuesi i Projektit ve ne dispozicion te tij, Librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e te furnizimit te objektit me materiale e produkte ndertimi.
- j. Ben njoftime brenda kohes se duhur per inspektimin e punimeve te maskuara, per marrjen e kampioneve, kryerjen e provave, te analizave qe parashikohen ne rregullat teknike ose kerkohen shtese nga Drejtuesi i Projektit, paraqet fotografite, kasetat filmike dhe cdo dokument tjeter qe provon saktesine e produkteve e te punimeve.
- k. Me Urdher te Drejtuesit te Projektit prish dhe riben me shpenzimet e Kontraktorit, brenda periudhes se korrigjimit te difekteve, punimet qe rezultojne me shkelje te kushteve teknike te zbatimit, standarteve e specifikimeve teknike, pershpejton kryerjen e punimeve tej grafikut dhe kohes normale te punes;  
Ne rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmerojë Drejtuesin e Projektit, i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

- 4.1. Drejtuesi Teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kerkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emelimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues Teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Drejtuesin e Projektit i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

## Neni 5


### Inspektimi dhe Testet

- 5.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës
- 5.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.
- 5.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.
- 5.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 5.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.
- 5.6 Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme që do të vendosen në objekt duhet të jenë të shoqëruar me çertifikata cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vertetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet që referohen në pershkrimet dhe specifikimet teknike.
- 5.7 Materialet dhe produktet e ndërtimit që nuk pranohen nga Drejtuesi i Projektit, për shkak se nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe të kontratës, nuk vendosen në objekt.

## Neni 6

### Realizimi i kontratës:

1. Kantieri i Punëve do të jetë **“Rikonstruksion rruga Krajej”**.
2. Dokumentacioni i detyrueshëm për tu administruar nga Kontraktori në fillim të zbatimit të kontratës bazuar në Vendimin Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si



NIKA SH.P.K  
NIPT: J78050470  
SHKODER



dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve” do të jete:

- a) dokumentacionin administrativo-ligjor për truallin dhe sheshin e ndërtimit;
- b) lejen e ndërtimit;
- c) projektin e zbatimit për punimet e ndërtimit, të infrastrukturës, montimit, sistemimit të territorit dhe preventivin e punimeve;
- ç) planin e vendosjes (piketimit) të objektit;
- d) përshkrimin teknik të punimeve dhe specifikimet teknike;
- dh) lidhjen e veprës me infrastrukturën e zonës;
- e) studimet inxhinierike, për ndërtimin e veprës (gjeologjik, sizmik, topografik, gjeoteknik, hidrologjik, hidraulik, të materialeve e produkteve të ndërtimit etj.).

## Neni 7

### Siguracioni

7.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
- b. Për dëmti me ose humbje të Pajisjeve:.
- c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
- d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier:

## Neni 8

### Data e Fillimit

8.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier menjëherë pasi të jetë bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Ky shesh do të dorëzohet në prani të Drejtuesit të Projektit dhe Kontraktorit dhe prej tyre do të mbahet një procesverbal për të zyrtarizuar këtë fakt.

## Neni 9

### Lloji i Kontratës

Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin ne Njesi  
 me kontratë me çelësa në dorë :

A. është hartuar nje projekt-preventiv orientues

B. nuk ka nje projekt-preventiv te hartuar, por vetëm një projektide apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokurohet  \_\_\_\_\_

## Neni 10

### Grafiku i Pagesës

10.1 Likujdimi do te behet brenda 30 diteve ditëve nga data që kontraktori paraqet faturen/faturat elektronike , situacionet e punimeve ose ne rastin e situacionit perfundimtar te shoqeruar me certifikaten e marrjes se perkohshme ne dorezim te punimeve dhe Aktin e Kollaudimit te objektit.

10.2 Monedha e pagesës do të jetë LEKE. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.



## Neni 11

### Shërbimet në Lidhje me to

- 11.1** Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të Lidhura

## Neni 12

### Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndërtimeve

- 12.1** Gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik në përputhje me legjislacionin fuqi.
- 12.2** Në përfundim të punimeve Kontraktori paraqet një deklaratë, në formën e njoftimit, për përfundimin e punimeve. Drejtuesi i Projektit dhe Kontraktori mbajnë një procesverbal ku përcaktohet data e përfundimit të punimeve. Drejtuesi i Projektit informon menjëherë Autoritetin Kontraktor për datën e përfundimit të punimeve.
- 12.3** Nëse drejtuesi i projektit zbulon se punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zërat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 12.4** Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në punime, ai i bën kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen
- 12.5** Kontraktori, bazuar në dokumentacionin teknik (të sipërcituar) të grumbulluar dhe përpunuar, në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve, harton deklaratën teknike për punimet e ndërtimit, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknik dhe ligjor të Kontraktorit, si dhe nga Drejtori Teknik i punimeve në kantier dhe së bashku me dokumentacionin e mësipërm i dorëzohet Drejtuesit të Projektit jo më vonë se 20 dite duke filluar nga dita e përfundimit të punimeve. Drejtuesi i Projektit, mbas verifikimeve, së bashku me miratimin e tij i paraqet dokumentacionin Autoritetit Kontraktor brenda jo më vone se 10 ditëve nga dita e dorëzimit të dokumentacionit të sipërpërmendur.
- 12.6** Një kopje e dokumentacionit të miratuar nga Drejtuesi i Projektit i dërgohet menjëherë, nga ky i fundit, kolaudatorit/grupit të kolaudimit. Kolaudimi do të fillojë menjëherë me marrjen e dokumentacionit të miratuar nga Drejtuesi i Punimeve dhe do të bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8402, dt.10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 3, dt. 15.02.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Kreut II "Per Kolaudimin e punimeve të ndërtimit". Në përfundim të kolaudimit hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori/grupi i kolaudimit, Kontraktori dhe Drejtuesi i Projektit. Autoriteti Kontraktor ose Drejtuesi i Projektit i autorizuar prej Autoritetit Kontraktor në përputhje me procesverbalin e kolaudimit do të lëshojë Çertifikatën e Përkohshme të Marrjes në dorëzim të punimeve. Brënda 10 diteve pas përfundimit të kolaudimit, Drejtuesi i Projektit, mbështetur në kontratë dhe në gjithë dokumentacionin tjetër përfshire atë teknik, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur Kontraktorit dhe i jepet për likuidim Autoritetit Kontraktor, i cili brenda 20 diteve, por jo me vone se 30 dite pas dates se marrjes në dorëzim të punimeve, do t'i kthejë Kontraktorit sigurimin e kontratës.
- 12.7** Kontraktori është përgjegjës për drejtimin, mbajtjen në gatishmëri, riparimin,



- mirëmbajtjen, ruajtjen e punimeve të ndërtim-montimit të objektit dhe kantierit, deri në heqjen e ndërtimeve të perkohshme dhe realizimin e punimeve perfundimtare të sistemimit
- 12.8** Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit. Kontraktori, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit, heq ndërtimet e perkohshme dhe realizon punimet perfundimtare të sistemimit.
- 12.9** Dosja e përbashkët teknike e objektit, pas kolaudimit të punimeve, arkivohet pranë Autoritetit Kontraktor. Kjo dosje është dokument i rëndesise së veçantë dhe ruhet sipas afateve të përcaktuara me ligj.
- 12.10** I gjithë dokumentacioni teknik dhe ekonomik dërguar Autoritetit Kontraktor nga Kontraktori, Drejtuesi i Projektit, kolaudatori etj, si: njoftime, procesverbale, fatura tatimore duhet të protokollohen në zyrën e Protokoll/Arkivës pranë Bashkisë Shkodër.
- 12.11** Në fund të periudhës së garancisë së punimeve Drejtuesi i Projektit dhe Komisioni i Marrjes në Dorëzim të objektit do të përpilojë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj kontrate (Certifikatën Përfundimtare të Marrjes në Dorëzim të Punimeve)

### **Neni 13**

#### **Situacionet**

- 13.1** Kontraktori do ti paraqesë Drejtuesit të Projektit, brenda 5 diteve të para të cdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të meparshme, garancine e defekteve, paradhënien etj. të kësaj natyre sikurse përcaktohet në këtë kontratë.
- 13.2** Drejtuesi i Projektit, duhet të kontrollojë punën e kryer nga kontraktori dhe duhet të vertetojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Drejtuesi i Projektit, përcakton vlerën e punimeve të kryera.
- 13.3** Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara pa prekur fondin rezervë i cili do te financohet në situacionin perfundimtar nëse ka dokumenta që vertetojne përdorimin e tij.

#### **PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR**

**BASHKIA SHKODËR**

**Kryetar i Bashkisë**

**Bardh SPAHIA**



#### **PER OPERATORIN EKONOMIK**

**” Nika”sh.p.k**

**Administrator ligjor**

**Shpresa NIKA**

**SH.P.K**  
**NIKASHKODER**  
**705047U**

